

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"KPK CLEANING" SHPK**

Sot, më datë 30/10/2024, u paraqiten personalisht:

- **Z. Hashmat Samadi**, i datëlindjes 22/01/2000, shtetas shqiptar, lindur ne Kabul, Afganistan dhe banues ne Gjermani, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i pasaportes me nr PO3104814.
- **Z. Rahman Ishaq**, i datëlindjes 01/01/1974, shtetas shqiptar, lindur ne Mohmand Agency, Pakistan dhe banues ne Gjermani, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i pasaportes me nr AV1843613.

Te cilet përpiluan këte akt themelimi të shoqërisë tregtare "KPK CLEANING" SH.P.K, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

**Forma Ligjore**

Të themeloj Shoqërinë Tregtare "KPK CLEANING" SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "KPK CLEANING" SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2**

**Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit "KPK CLEANING" SH.P.K dhe me emrin tregtar **KPK CLEANING**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- Shërbim, pastrim sanitar i ambjenteve të brendshme dhe të jashtme, mirëmbajtje, pastrim, gjelbërim të ambjenteve të subjekteve publike dhe private.

*Ishaq*



## NENI 5

### Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: **Apartament Nr. 44, H. 1, Pallati " Liseci", Rr. Hamdi Sulçebe, Tiranë.**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

## NENI 6

### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është Lekë 100.000 (njqind mije leke) dhe zotërohet nga ortakët themelues:

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: Lekë 100.000 njqind mije leke)

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 2.

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortakët themelues.

## NENI 7

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare "KPK CLEANING" SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortaku themelues :	<b>Hashmat Samadi</b>
Numri i kuotave :	<b>1</b>
Numri i pjeseve :	<b>1</b>
Pjesëmarrja në Shoqëri :	<b>50,00 %</b>
Lloji i kontributit:	<b>Ne para</b>
Vlera e kontributit	<b>50,000 ( pesedhjetë mije) leke</b>

Ortaku themelues :	<b>Rahman Ishaq</b>
Numri i kuotave :	<b>1</b>
Numri i pjeseve :	<b>1</b>
Pjesëmarrja në Shoqëri :	<b>50,00 %</b>
Lloji i kontributit:	<b>Ne para</b>
Vlera e kontributit	<b>50,000 ( pesedhjetë mije) leke</b>

Duke qenë se Kapitali themeltar do të depozitohet në llogarinë e Shoqërisë e cila do të hapet pas regjistrimit në QKB, atëherë ortakët vendos që kjo shume do të paguhet prej tij jo më vonë 3 muaj nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, në llogarinë e shoqërisë tregtare.  
Rregullat e pagesës së kësaj shume janë parashikuar në këtë Statut.

*Ishaq*



## NENI 8

### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## NENI 9

### Administratori/ët

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqërisë do të jete :

- **Z. Hashmat Samadi**, i datëlindjes 22/01/2000, shtetas shqiptar, lindur ne Kabul, Afganistan dhe banues ne Gjermani, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i pasaportes me nr PO3104814.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## NENI 10

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## NENI 11

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

## NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

## NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues, u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaku eshte njohes te gjuhes shqipe.

## ORTAKU THEMELUES

Hashmat Samadi

Rahman Ishaq